



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 10

Datë: 14. 04. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq,

- Rishikimi dhe miratimi i Qendrave të Votimit në komunat Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan,

- Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve që shtypen për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Lepsaviq dhe Zubin Potok, si dhe numrit të fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunitat e Zveçanit dhe Lepsaviqit,

- Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të KVV-të për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Lepsaviq dhe Zveçan,

- Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së bazës së shenimeve të departamentit të pensioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,

Këshilli Mbiqkyrës për Informim Publik

Shqyrtimi dhe miratimi i Llogos dhe dizajnit të produkteve të IP për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Lepsaviq dhe Zveçan, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Lepsaviq

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Fillimisht, kryetari Radoniqi, e hapi mbledhjen dhe paraqiti para anëtarëve të KQZ-së rendin e ditës. Pas kësaj, Ariat Elshani kërkoi që nga raportet e KOZ, të hiqet nga rendi i ditës pika: “ Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së bazës së shenimeve të departamentit të pensioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve”. Kurse, Burim Ahmetaj, po ashtu kërkoi që në lidhje me KOZ-in, të bëhet ndryshimi i anëtarit të KQZ-së në këtë këshill, pra zëvendësimi i anëtarit të KOZ-it.

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Rishikimi dhe miratimi i Qendrave të Votimit në komunat Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Lepsaviq dhe Zveçan:

Arianit Elshani: Si komision kemi miratuar më 1 mars në nivel nacional QV-të, duke përfshirë edhe katër komunat veriore ku do të mbahen zgjedhjet. Nga komunikimi dhe korrespeodencat, nga rekomandimet e marra, nga komunikimi me drejtorët e shkollave – menaxherët e QV-ve, është konstatuar se nga 44 QV sa është zhvilluar procesi në të kaluarën, 8 prej tyre mund të hapen. Mirëpo, tash është konstatuar vetëm 6 prej tyre, aktualisht mund të hapen, dhe se 13 QV do të jenë alternative. Pra, objektet do të sigurohen. Prandaj, ne rekomandojmë miratimin e këtyre qendrave dhe pastaj, ato të bëhen publike...

Ilir Gashi, tha se realisht, nuk kemi dokument mbështetës që shpjegon se pse kemi arritur deri te “detyrimi për hapjen e qendrave alternative”! Pra, ne duhet të kemi një bazë, një dokument etj. Pra, të informohemi...

Burim Ahmetaj, ne jemi në komunikim me organet e sigurisë, me KKZ-të, me drejtorët e shkollave dhe se, në bazë të këtyre fakteve komunikuese, këto janë lokacionet më të mundshme ku, edhe janë të përfshirë votuesit...

Kemi pranuar raportet nga KKZ, ku ne rekomandohemi ti hapim, e ndërsa 13 janë alternative. Arianit Elshani, tha se edhe KQZ ka marrë përsipër koston e vetë, informimin për qendrat e reja, ku do të vendosen saktë qendrat alternative...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për këtë rekomandim ?

Kemi 8 vota për, dhe një abstenim. Miratohet rekomandimi për miratimin e Qendrave të Votimit në komunat Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan,

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviç:

Arianit Elshani: Ne, në KOZ kemi shqyrtuar rritjen e numrit të votuesve për vendvotime, por edhe uljen e numrit të vendvotimeve, dhe nga 69 sa kanë qenë të parapara, 34 vendvotime. Dhe nga 750 sa ka qenë numri i votuesve, propozojmë të rritet në 2000 votues. Kjo, mund të jetë sifiduese, por ne rekomandojmë për miratim.

Me 10 vota për, dhe një abstenim miratohet ky rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të KVV-të për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan:

Arianit Elshani: Me gjithë volumit të shumë dokumenteve, ne kemi shqyrtuar miratimin e KVV-të për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan, dhe me nominimet e pranuar deri më tash nga subjektet politike, për Mitrovicën e veriut kemi 64 nominime. Sa i përketë komunës së Leposaviqit, janë të nominuar 58 KVV, për Zveçan 28 nominime, dhe Zubin Potok: 22 nominime. Rekomandojmë që të miratohet kjo përbërje e këshillave...

Me 10 vota për dhe një abstenim, miratohen KVV-të.

Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve që shtypen për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok, si dhe numrit të fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit:

Arianit Elshani: Gjithashtu, KOZ ka shqyrtuar numrin e fletëvotimeve dhe broshurave që do të shtypen. Rekomandimi i ardhur nga sekretariati është që të prodhohen në total: 43500 fletëvotime për katër komunat, kuptohet këtu është edhe sasia rezervë e planifikuar. Po ashtu, edhe 19 500 broshuara, përfshi edhe ato rezervë.

Me vota unanime, miratohet edhe ky rekomandim

Shqyrtimi dhe miratimi i formave zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok, si dhe numrit të fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar edhe format zgjedhore, fizikisht nuk janë por i keni në mënyrë elektronike në imella. Janë të gjitha format, FRP-të, posterët... Dhe ne, rekomandojmë miratimin e formave zgjedhore...

Me vota unanime, miratohet edhe ky rekomandim

Këshilli Mbiqyrës për Informim Publik

Shqyrtimi dhe miratimi i Llogos dhe dizajnit të produkteve të IP per zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq:

Fazli Stollaj, tha se këshilli mbikëqyrës i IP ka miratuar sloganin dhe llogon e këtyre zgjedhjeve. KQZ, duhet t'i miratojë...Materiali është shpërndarë, dhe ne rekomandojmë për miratimin... Gjithashtu, rekomandojmë edhe miratimin e produkteve të tjera informuese...

Me vota unanime miratohet llogoja dhe sloganet, si dhe produktet e tjera.

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të Këshillit për Operacione Zgjedhore

Kreshnik Radoniqi: E kemi propozimin për zëvendësimin e anëtarit të deritashëm të KOZ z. Rifat Krasniq, me anëtarin Ibrahim Selmanaj.

Kush është për ?

Me 10 vota për, miratohet.

3. Të ndryshme !